



REPUBLICA E KOSOVES	REPUBLIKA KOSOVA	REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDIKOMUNAL ASAMBLA	OF MUNICIPALITY SKENDERAJ NA OPSTINE	
SKENDERAJ		
Nr.	04-400/01-0030304/hz	
No.		
Data:	27 2024	
Data.		

Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

**Ekstrakt i procesverbalit nga dëgjimi buxhetor me grupet e interesit (biznese, shoqërinë civile, klube sportive, artistët, qytetarë të tjera)**

**Salla e Kuvendit Komunal Skenderaj**  
**Më 10.06.2023, ora 13.00**

**Albert Rexhepi:** Fillimisht po ju kërkojmë falje për mungesën e kryetarit dhe drejtorit të financave por për shkak të një agjende të papritur po mungojnë në hyrje të takimit. Qëllimi i këtij takimi është dëgjimi i kërkesave të qytetarëve për projekte të ndryshme pasi është faza e hartimit të buxhetit komunal për fitin 2025 dhe vitit 2026-27. Si procedurë merren kërkesat e juaja e pastaj shikohen mundësitë buxhetore që këto kërkesa të përfshihen në buxhet i cili dërgohet në Ministri të financave. Fjalën ja kaloj drejtorit të DKRS-së Alban Berisha.

**Alban Berisha:** Përshëndetje për të gjithë, me këtë rast jemi mbledhur për të dëgjuar kërkesat dhe nevojat tuaja dhe të njëjtat t'i adresojmë për trajtim të mëtejshëm në bazë të mundësive buxhetore. Në DKRS kërkesat dhe mbështetjen e bazojmë në bazë të rregullores për subvencione. Vitin e kaluar kemi ndarë një vlerë prej 150,000 euro kurse për vitin e ardhshëm planifikojmë të rrisim këtë shumë në 185,000 euro kurse subvencione ndahen edhe nga drejtoritë e tjera dhe nga Zyra e Kryetarit.

**Albert Rexhepi:** Urdheroni kush dëshiron fjalën.

**Gentiana Zeqiri:** Përshëndetje për të gjithë, Jam Gentiana Zeqiri që këtu përfaqësoj OJQ-në "Iniciativa Qytetare Skenderaj" por jam edhe si qytetare e Klinës së Poshtme. Si OJQ kemi dhënë rekomandimet tonë, Amiri e din për përbushjen e dy kritereve të cilat e bëjnë Skenderajn numër një në transparencë komunale. Çështja që dua ta ngris këtu është ngritja e subvencioneve në Drejtorinë e Administratës sepse shuma aktuale prej 10,000 euro është e vogël. Si dhe çështja e mungesës së ndriçimit publik në Klinë të Poshtme.

**Amir Lushtaku:** Faleminderit shumë për pyetjen, unë që në fillim i kam ngritur këto çështje që kanë të bëjnë me transparencën komunale dhe i kam adresuar edhe dy çështjet e fundit dhe Këshillat e Fshatrave janë në procedurë të formimit. Sa i përket ndriçimit publik, ju njoftoj se procedurat e prokurimit vec kanë përfundu, kontrata është lidhë me operatorin ekonomik dhe punimet pritet të fillojnë shumë shpejt në Klinë të Poshtme si zotim i yni që të fillojmë aty për të vazhduar me radhë në qytet dhe në vendbanime të fshatrave.

**Alban Berisha:** Genta, Faleminderit IQS-së për angazhimin e saj kurse do ta adresojmë tek drejtori i Administratës që brenda mundësive të rritet suhvencionimi në këtë drejtori.

**Serbeze Zabeli:** Dua ta ngris çështjen e mungesës së ndriçimit në lagjen 2 gjë e cila po krijon pasiguri pasi ka shumë qenë endacakë të cilët janë të rrezikshëm për banorët sidomos nxënësit. Gjithashtu rruga “Mujë Krasniqi” në lagjen 2 është e dëmtuar dhe ka nevojë për ndërhyrje.

**Albert Rexhepi:** Faleminderit shumë, a ka dikush ndonjë çështje tjetër urdhëroni lirisht.

**Fikrije Hajdari:** Ndriçimi vec u cek mirëpo të rrethi i Morinës ka nevojë që të vendosën pengesa dmth policë të shtrirë pasi veturnat lëvizin shpejt.

**Alban Berisha:** Ndriçimi do të bëhet së shpejti. Kurse për disa procedura ku kërkohet të lidhen kontrata përmes prokurimi duhet të presin afatet ligjore deri sa të kryhen krejt procedurat e nevojshme. Problemin e geneve endacak jemi mundu me trajtu mirëpo për shkak të mundësive të vogla financiare nuk kemi arrit më shumë. Kastrimi është bërë tek një pjese e geneve në rreth 500 të tillë nga Drejtoria e Bujqësisë bashkë me një fondacion dhe kjo është maksimumi që kemi mundur të bëjmë.

**Fikrije Hajdari:** Në këtë lagje pra në rrugën “Mujë Krasniqi” dhe “Miftar Bajraktari” një pjesë e dheut ka rreshqit dhe po shkakton problem në qarkullimin e lirë.

**Alban Berisha:** Çështja e gungave në këtë rrugë është nën menaxhimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe e kemi të vështirë të ofrojmë zgjidhje aty.

**Sadije Xhokaj:** Deshta të pyes lidhur me pastrimin e lumit në lagjen Spahiu pasi 3 herë na ka vërvshuar dhe është problematikë që po vazhdon. A ka ndonjë zgjidhje për këtë problem?

**Alban Berisha:** Faleminderit për pyetje. Trajtimi i lumit Klina në disa pjesë veç ka përfundu është sfidë pasi i dini pasojat nga vërshimet e janarit 2023 dhe dëmet e mëdha të cilat po mundohemi me i riparu.

**Amir Lushtaku:** Komuna është duke e hartu projektin për ndërtimin e murit mbrojtës brenda qytetit i cili do të shërbejë si mbrojtje në rast të vërvimeve të mëdha. Fillimisht do të bëhet nga ura kryesore e qytetit në drejtim të shkollës “Ahmet Delia” dhe brenda mundësive buxhetore do të vazhdojë në drejtim të Llaushës. Shpresojmë që nuk do të ketë pengesa pronësore.

**Granit Koci:** Përshëndetje të gjithëve, jam Drejtor i KF Drenica, falënderojmë komunën për përkrahjen e vazhdueshme ndaj KF Drenica. Deshta të pyes se kur pritet të përfundojë projekti për ndërtimin e tribunave të stadiumit që veç kanë fillu si dhe vite më herët është përmend ndërtimi i një fushe sportive të re në qytet por më vonë është thënë se është largu si projekt.

**Alban Berisha:** Faleminderit për pyetjen. Ju e dini që projekti i ndërtimit të tribunave po bëhet pa qenë fare premtim dhe jemi të angazhuar që këtë Project ta përfundojmë sa më shpejt por ka problem me ujëra nëntokësore kurse po bëjmë presion të operatori ekonomik që të vazhdojë me punime kurse rrëth afateve kohore nuk mund të japim. Po besoj që sezoni i ardhshëm do të fillojë me tribunën e re.

**Granit Koci:** Harrova me përmend edhe rrugën që është dëmtu nga vërshimet, kur pritet me u rregullu tërësisht.

**Amir Lushtaku:** Sa i përket rrugës ju e dini që ajo pjesë ka qenë shumë e dëmtuar nga vërshimet. Brenda mundësive tonë ne e kemi trajtuar me zhavor atë pjesë kurse shpresojmë që brenda vitit ta rregullojmë tërësisht.

**Sanije Geci:** Në Llaushë tek rruga e Lanëve 20 metra në hyrje të saj rruga është e dëmtuar dhe çdo ditë po gërryhet. A pritet diçka për këtë rrugë?

**Albert Rexhepi:** Do ta përcjellim këtë kërkesë tek drejtoria përkatëse.

**Amir Lushtaku:** Vërshimet e 19 janarit 2023 kanë shkaktuar dëme në vlerë mbi 12 milion e 200 mijë euro. Vetëm në infrastrukturë publike janë afér 6 milion euro dëme dhe nuk ka asnje cent si kompenzim nga Qeveria e Kosovës. Krejt çka kemi ndërhyrë është me buxhetin tonë vetanak i cili është fokusuar në rindërtim pas dëmeve shkaterruese të vërvimeve.

**Albert Rexhepi:** Nëse nuk ka dikush ndonjë çështje tjeter, ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj dhe këto kërkesa do t'i adresojmë për trajtim të mëtejshëm me qëllim që të përfshihen në planifikim të buxhetit.

Procesmbajtës:

Amir Lushtaku

